

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kostoja e shëndetit, 8% e shqiptarëve nuk përballojnë ekzaminimet, e dyta më e lartë në Europë
ADRESA	https://versus.al/ekonomi-mjedis/kostoja-e-shendetit-8-e-shqiptareve-nuk-perballojne-ekzaminimet-e-i46995
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:45:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 06:02:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c1ef5395fe6113095d40ba6803cc88ad0c7a12ffffce708e7bf590ab32dbe80ec
TEKSTI	fe8f84f02e1bcba653868db7f20f8a10c63b726575faa00421d2dd3baf9782a2
PAMJA	b3d4b41e04d3ef3fbda0dfefd489bb891f1350ffe624da9993c3cd5bf1f82f61

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	49920e4001b5a9ec9328478d0c639da94154904b9501c1b6ed0e384e66fa1eb6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/49920e4001b5a9ec9328478d0c639da94154904b9501c1b6ed0e384e66fa1eb6

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

"Na kanë bërë shumë gjëra o shpirt"/ Vlera Hyseni dhe Ergys Agasi mbi 500 mesazhe në 2 muaj në Signal. Shefja e SHISH i dha materiale sekrete, merret në pyetje nesër në GJKKO!

23 Shtator 2026, 13:50

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[EKONOMI & MJEDIS](#) / 23 Shtator 2026, 08:02

Kostoja e shëndetit, 8% e shqiptarëve nuk përballojnë ekzaminimet, e dyta më e lartë në Europë



Shkruar nga Versus



Shqipëria është ndër vendet europiane ku kostoja pengon më shumë qytetarët të marrin kujdesin shëndetësor që u nevojitet. Në vitin 2024, 8% e popullsisë 16 vjeç e lart raportoi se nuk kishte kryer një ekzaminim mjekësor të nevojshëm, sepse ishte shumë i shtrenjtë.

Në të dhënat më të fundit të disponueshme të Eurostat, vetëm Greqia ka një nivel më të lartë, me 8.8% në vitin 2025. Mesatarja e Bashkimit European për vitin 2025 ishte vetëm 1%.

Pas Greqisë dhe Shqipërisë, diferenca është e madhe. Në vitin 2025, pamundësia për të përballuar financiarisht ekzaminimin prekte 2.5% të popullsisë në Letoni, 2% në Rumani, 1.9% në Francë dhe 1.6% në Itali.

Kostoja mbetet pengesa kryesore në Shqipëri

Në Shqipëri, në vitin 2024, përveç 8% që nuk e përballonin koston, 1.5% deklaruan se nuk kishin marrë ekzaminimin për shkak të listës së pritjes dhe 0.2% për shkak se shërbimi ndodhej shumë larg. Të tria së bashku përbënin 9.8% të popullsisë.

Për krahasim, në BE në vitin 2025 vetëm 1% e popullsisë raportoi koston si pengesë. Listat e pritjes përbënin një arsye për 1.2% të popullsisë së BE-së dhe largësia nga shërbimi për 0.1%. Të marra së bashku, këto tri pengesa prekën 2.4% të popullsisë së BE-së.

Nga mungesa e kohës te frika nga mjeku

Të dhënat e detajuara të Eurostat tregojnë se pengesat për marrjen e kujdesit në Shqipëri nuk kufizohen vetëm te sistemi shëndetësor.

Në vitin 2024, 2% e popullsisë 16 vjeç e lart deklaroi se nuk e kishte kryer ekzaminimin sepse kishte preferuar të priste për të parë nëse problemi do të përmirësohej vetë. Kjo ishte arsyeja e dytë më e shpeshtë pas koston, nëse merren veçmas të gjitha arsyet e deklaruar.

Mungesa e kohës ishte gjithashtu një pengesë e rëndësishme. Rreth 1.8% e popullsisë deklaroi se nuk kishte pasur kohë për të kryer ekzaminimin, nga 1.6% në 2023 dhe 1.5% në 2022.

Një pjesë më e vogël e qytetarëve, 0.2%, deklaroi si arsye frikën nga mjeku, spitali, ekzaminimi ose trajtimi, ndërsa 0.1% raportoi se nuk njihte një mjek ose specialist të mirë. Një tjetër 1% përmendi arsye të tjera.

Kur merren parasysh të gjitha arsyet e raportuara nga Eurostat, jo vetëm kostoja, largësia dhe pritja, 85.1% e shqiptarëve deklaruan në vitin 2024 se nuk kishin pasur nevojë të plotësuara për ekzaminim mjekësor dhe 14.9% kishin raportuar një nevojë të plotësuara për të paktën një nga arsyet e përfshira në anketë.

Shqipëria shumë mbi rajonin për pengesën financiare

Edhe në raport me Ballkanin Perëndimor, Shqipëria ka nivelin më të lartë të mosmarrjes së ekzaminimeve për shkak të koston.

Në Serbi, ku ka tashmë të dhëna për vitin 2025, vetëm 1.1% e popullsisë raportoi se ekzaminimi ishte shumë i shtrenjtë. Për Maqedoninë e Veriut, vlera e fundit e disponueshme është 1.2% në vitin 2024, ndërsa për Malin e Zi 0.3% në të njëjtin vit.

Për Bosnjë-Hercegovinën, e dhëna e fundit është 0.4% dhe i përket vitit 2023, ndërsa për Kosovën nuk ka të dhëna në serinë e përdorur.

Shpenzimet e ulëta dhe pagesat e larta nga xhepi

Niveli i lartë i mosmarrjes së ekzaminimeve për shkak të koston përkon me konsum të ulët të për shëndetësinë në Shqipëri dhe me një barrë financiare shumë më të lartë që bie drejtpërdrejt mbi familjet.

Të dhëna të tjera të Eurostat bënë të ditur se konsumi individual për shëndetësinë në Shqipëri ishte 662 euro për banor në vitin 2025, kundrejt 3,675 eurove mesatarisht në BE. Edhe pasi eliminohet efekti i diferencave të çmimeve, konsumi real i mallrave dhe shërbimeve shëndetësore në Shqipëri ishte vetëm rreth 40% e mesatares europiane.

Sipas Bankës Botërore, Në vitin 2023, 48.27% e shpenzimeve korrente për shëndetësinë në Shqipëri paguheshin drejtpërdrejt nga familjet, niveli më i lartë në Europë. Në BE, pagesat nga xhepi përbënin mesatarisht vetëm 14.9% të shpenzimeve shëndetësore.

Burimet publike vendase financonin rreth 49.6% të shpenzimeve korrente për shëndetësinë në Shqipëri, ndërsa në BE skemat e detyrueshme të sigurimit dhe skemat qeveritare mbulonin së bashku 80.6% të fatursë.

Metodologjia

Të dhënat bazohen në treguesin e Eurostat për nevojat e vetëraportuara të plotësuara për ekzaminim mjekësor, sipas arsyes kryesore të deklaruar. Anketa përfshin si arsye koston, largësinë dhe listat e pritjes, por edhe mungesën e kohës, mosnjohjen e një mjeku apo specialisti të përshtatshëm, frikën nga mjeku, spitali, ekzaminimi ose trajtimi, pritjen për të parë nëse problemi përmirësohet vetë dhe arsye të tjera.

Treguesi i referohet popullsisë 16 vjeç e lart dhe bazohet në vlerësimin e vetë personit nëse kishte nevojë për ekzaminim ose kujdes mjekësor, por nuk e mori apo nuk e kërkoi atë.

Për Shqipërinë, të dhënat më të fundit në tabelën e Eurostat janë për vitin 2024. Për BE-në, Greqinë dhe vendet e tjera ku të dhënat e vitit 2025 janë të disponueshme, në krahasim është përdorur viti 2025. Për vendet ku 2025 mungon, është përdorur viti më i fundit i disponueshëm dhe viti është specifikuar në tekst. **Monitor.al**

Tags:

[shendeti fizik dhe mendor shendetesia ne shqiperi](#)

Poll



EKONOMI & MJEDIS

[Në 2027 nis ndërtimi i hekurudhës Vorë-Hani i Hotit, Karakaçi: Në nëntor shpallet fituesi për Durrës-Rrogozhinë](#)

23 Shtator 2026, 17:40

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Kreditë për shtëpi dhe sulmet kibernetike/ Banka e Shqipërisë paralajmëron: Sytë duhen mbajtur hapur!](#)

23 Shtator 2026, 17:23

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Tatimet me "dorë të hekurt" ndaj bizneseve debitore. propozohet mbledhje me forcë e detyrimeve të parapagimit të tatimit mbi fitimin](#)

22 Shtator 2026, 17:15

^ekstrakti^





EKONOMI & MJEDIS

[Paradoks popullsie në Shqipëri, lindin më shumë djem, por në vend ka 28 mijë femra më shumë](#)

22 Shtator 2026, 13:24

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Hetimet dhe sekuestrimit e SPAK ulin kërkesën për apartamente, kush po blinte?!](#)

22 Shtator 2026, 08:05

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Çmimet e shtrenjta të ushqimeve, si e arriti dhe e kaloi Shqipëria mesataren e BE?](#)

21 Shtator 2026, 08:02

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Çfarë po ndodh me monedhat e huaja? Ja sa shitet dhe blihet euro dhe dollari](#)

20 Shtator 2026, 08:16

^ekstrakti^





EKONOMI & MJEDIS

Bordi i Transparencës cakton çmimet e reja për naftën dhe benzinën

19 Shtator 2026, 10:17

^okstrakti^

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.